

VENDIM
Nr. 547, datë 9.8.2006

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

(Ndryshuar me VKM nr. 202, datë 11.4.2007; nr. 364, datë 13.6.2007; nr.1483, datë 12.11.2008; nr. 23, datë 20.1.2010; nr. 930, datë 29.12.2014; nr. 206, datë 15.3.2017; nr. 332, datë 6.6.2018; nr. 506 datë 1.8.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e *Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si institucion në varësi të *Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë*, me seli në Tiranë.

1/1. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ushtron detyrat e agjencisë përgjegjëse për energjinë e rinovueshme.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe *energjetikë*.

3. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Konsulton, propozon dhe bashkëpunon me strukturat përkatëse të qeverisë për hartimin e politikave të saj në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe të *energjetikës*;

- Zbaton politikat e qeverisë në fushën e minierave, të hidrokarbureve dhe *energjetike*;

- *Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën teknike për studimet e projektet në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe energjetike, të paraqitura nga subjektet, shtetërore a private, vendëse ose të huaja, sipas tarifave të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për raste të veçanta mund të kërkojë asistencë të specializuar;*

- Promovon burimet minerare e hidrokarbure, negocion marrëveshjet hidrokarbure dhe minerare, si dhe ndjek zbatimin e planeve të zhvillimit të tyre;

- Përgatit dokumentacionin dhe praktikat e nevojshme për dhënien e lejeve, të licencave, autorizimeve, në përputhje me ligjin, të cilat mundësojnë hyrjen në marrëveshjet hidrokarbure dhe kryerjen e operacioneve hidrokarbure, sipas marrëveshjeve të lidhura;

- Mbikëqyr veprimtarinë minerare, postminerare, hidrokarbure dhe *energjetike*;

- Ndjek zbatimin e marrëveshjeve të lidhura hidrokarbure;

- Realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;

- Administron, ekskluzivisht, të gjitha të dhënat parësore të sektorit hidrokarbur dhe të dhënat, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.

- *Shërben si organ i specializuar për ministrin përgjegjës për energjinë, për problemet e strategjisë dhe të politikës në këtë fushë;*

- *Promovon burimet e rinovueshme të energjisë, si dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin energjetik;*

- *Harton dhe publikon bilancin energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë;*

- *Monitoron kontratat koncesionare ose jo objekt koncesioni për centralet prodhuese me burime të*

rinovueshme. Monitorimi i prodhimit të energjisë elektrike do të kryhet çdo 5 vjet dhe, për efekt penalteti, vlerësimi do t'i referohet mesatares së prodhimit të energjisë, duke filluar nga viti i parë i plotë financiar i vënies në punë të hidrocentralit.

- Lëshon certifikatat vjetore të monitorimit për centralet prodhuese nga burime të rinovueshme, sipas tarifave të përcaktuara në anekset 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

- Drejton dhe bashkërendon punën me strukturën e specializuar të Kombeve të Bashkuara, Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), si dhe ndërmjet strukturave shtetërore, institucioneve të specializuara, vendase dhe të huaja, universiteteve dhe qendrave kërkimore-shkencore, vendase dhe të huaja, sektorit privat, organizatave jofitimprurëse, grupeve të interesit etj., për të krijuar infrastrukturën kombëtare të nevojshme (përfshirë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, strukturat e specializuara të domosdoshme etj.), për vënien në jetë dhe në funksion të programit të energjisë bërtamore në Shqipëri.

-Shfuqizuar;

- Harton raportet e vlerësimit të impianteve me burime të rinovueshme dhe hidrocentraleve objekt koncesioni ose jo objekt koncesioni dhe lëshon certifikatën e pranimit të veprës, sipas anekseve 2 dhe 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

- Përllogarit dhe aplikon penaltete ndaj shoqërive për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale;

- Njofton organet shtetërore përgjegjëse, në rast se konstaton mospërbushje të detyrimeve kontraktuale dhe shkelje të dispozitave ligjore.

4. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është ent publik, i krijuar nga bashkimi i Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve, Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Metalurgjisë, Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve dhe Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Mekanikës dhe Drurit dhe Agjencia Kombëtare e Energjisë.

5. Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore siguron burime financiare nga:

a) të ardhura, të cilat i siguron nga ofrimi i shërbimeve sipas veprimtarisë së saj në fushën minerare, hidrokarbure, energjetike, si dhe tarifa të tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

b) buxheti i shtetit, nëpërmjet projekteve që ministria ose institucione dhe organe të tjera shtetërore kërkojnë për t'u realizuar nga AKBN-ja. Fondet buxhetore të marra nga AKBN-ja nëpërmjet projekteve u nënshtrohen rregullave e procedurave të përcaktuara në ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Të ardhurat e mbledhura nga tarifat e shërbimeve të përcaktuara sipas anekseve bashkëlidhur këtij vendimi derdhen në llogarinë bankare të AKBN-së dhe kalojnë në buxhetin e saj.

Buxheti i AKBN-së miratohet nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë sipas propozimit të këshillit drejtues.

6. Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore i kalojnë të gjitha të drejtat e detyrimit e përcaktuara me akte të mëparshme nënligjore, ato kontraktuale, asetet dhe llogaritë bankare, të institucioneve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi.

7. Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statutregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

8. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtuesit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore bëhen me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Drejtori ekzekutiv, për efekt të pagës, klasifikohet në të njëjtin nivel me sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës.

9. Buxheti, për vitin 2006, për këtë institucion, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

9/1 a) Vlera prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Energjisë, në buxhetin e vitit 2007, programi "Mbështetje për energjinë", zëri "Studime e projekte", të transferohet në programin "Mbështetje për burimet natyrore", zëri "Studime e projekte".

b) Përballimi i shpenzimeve për pagat e punonjësve që dalin të papunë nga ristrukturimi, të

bëhet nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Agjencinë Kombëtare të Energjisë, programi “Mbështetje për energjinë” prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, zëri “Shpenzime korrente”.

10. Vendimet nr.445, datë 3.9.1993 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve”, nr.66, datë 6.10.1978 “Për krijimin e Institutit të Studimeve dhe Projektmeve të Metalurgjisë”, të Këshillit të Ministrave, dhe në lidhjen I “Institutit i Studimeve dhe Projektmeve të Mekanikës dhe Drurit (ISPMD)” të vendimit nr.197, datë 18.3.1996 të Këshillit të Ministrave “Për rrjetin e institucioneve shkencore shtetërore”, si dhe urdhri i Ministrit, nr.4685/1, datë 1.9.1993 “Për krijimin dhe organizimin e Institutit të Teknologjisë Nxjerrëse dhe Përpunuese të Mineraleve”, shfuqizohen.

10/1. Vendimet nr.443, datë 16.7.1998 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Energjisë” dhe nr.310, datë 15.5.2003 “Për miratimin e strukturës së nivelit të pagave të punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Energjisë” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

11. Ngarkohet Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKSI 1

(ndryshuar me VKM nr. 506, datë 1.8.2024)

Tarifat për shërbimet e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për subjektet minerare:

Tarifa e Oponencës Teknike

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e oponencës teknike	150,000

Tarifat për kryerjen e aktverifikimit sipas rretheve (me kërkesë të subjekteve)

Nr.	Rrethi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
1	Mirditë	89,700
2	Pukë	210,600
3	Kukës	215,800
4	Has	222,300
5	Mati	204,100
6	Bulqizë	213,200
7	Krujë, Tiranë	79,300
8	Kurbin	89,700
9	Shkodër	204,100
10	Lezhë	93,600
11	Malësi e Madhe	209,300
12	Dibër	218,400
13	Korçë	218,400
14	Berat	202,800

15	Devoll	223,600
16	Mallakastër	205,400
17	Tropojë	256,100
18	Skrapari	214,500
19	Elbasan, Peqin	81,900
20	Kolonjë	236,600
21	Gjirokastrë	245,700
22	Kavajë	81,900
23	Lushnjë	87,100
24	Librazhd	96,200
25	Vlorë	209,300
26	Përmet	218,400
27	Pogradec	205,400
28	Sarandë, Delvinë	248,300
29	Fier	102,700
30	Tepelenë	235,300

Tarifa për shërbimin e Këshillit Teknik

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e Këshillit Teknik	100,000

Tarifat për dhënie studimi-projekti të materialeve, dorëzuar nga subjektet

Në lekë (pa TVSH)

Formati fletës	Kopje bardhezi	Kopje me ngjyra	Tarifë për dokumentet e skanuar
A5	25 lekë/fleta	50 lekë/ fleta	10 lekë/fleta
A4	50 lekë/fleta	100 lekë/ fleta	20 lekë/fleta
A3	100 lekë/fleta	200 lekë/ fleta	50 lekë/fleta
Për materialet grafike me madhësi A2 e sipër, dhënia e tyre të llogaritet:			
A2	200 lekë/fleta	400 lekë/fleta	100 lekë/fleta
A1	400 lekë/fleta	800 lekë/fleta	200 lekë/fleta
A0	800 lekë/fleta	1400 lekë/fleta	300 lekë/fleta
Për çdo format harte më të madh se A0	800 Lekë/m ²	1400 Lekë/m ²	300 lekë/m ²
<i>Shënim. Për dhënien e materialeve me CD në çmim do të llogaritet - Plus 100 lekë/CD</i>			

Tarifa e miratimit të planeve vjetore të punës

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e miratimit të planeve vjetore të punës	300,000

Tarifat e miratimit të projekteve të depozitimit të mbetjeve (çdo 5 vjet)

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e miratimit të projekteve të depozitimit të mbetjeve për uzinat e	500,000

ferrokromit	
Tarifa e miratimit të projekteve të depozitimit të mbetjeve për fabrikat e bakrit	500,000
Tarifa e miratimit të projekteve të depozitimit të mbetjeve për fabrikat e kromit	350,000
Tarifa e miratimit të projekteve të depozitimit të mbetjeve për impiantet e tjera përpunues	150,000

Tarifat e miratimit të projekteve (kartave) teknologjike (aplikohet vetëm një herë)

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e miratimit e projekteve(kartave) teknologjike për uzinat e ferrokromit	500,000
Tarifa e miratimit e projekteve(kartave) teknologjike për fabrikat e bakrit	500,000
Tarifa e miratimit e projekteve(kartave) teknologjike për fabrikat e kromit	350,000
Tarifa e miratimit e projekteve(kartave) teknologjike për impiantet e tjera përpunues	150,000

ANEKSI 2

(shtuar me VKM nr. 506, datë 1.8.2024)

Tarifat për shërbimet e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për shoqëritë koncesionare/mbajtëse të miratimit në fushën hidroenergjetike:

Tarifa e Oponencës Teknike

Për hidrocentralet	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Me fuqi të instaluar deri në 1MW	500,000
Me fuqi të instaluar nga 1MW deri në 3MW	700,000
Me fuqi të instaluar nga 3MW deri në 10MW	1,000,000
Me fuqi të instaluar mbi 10 MW	1,500,000

Tarifa për vlerësimin e investimit

Emërtimi	Tarifa
Tarifa e vlerësimit të investimit	1 % e vlerës së investuar, por në çdo rast nuk do të kalojë vlerën prej 15,000,000 lekësh pa TVSH

Tarifat për certifikatën vjetore të monitorimit

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
0–0.5 mw	30,000
0.5–1 mw	80,000
1–2 mw	150,000
2–5 mw	300,000
5–10 mw	600,000
Mbi 10 mw	1,000,000

Penalitet për mosraportim sipas detyrimit kontraktual

Emërtimi	Vlera në lekë
Penalitet për mosraportim	100,000
Penalitet për përsëritje të shkeljes së mosraportimit	200,000

Vendosje e penalitetit nuk përjashton subjektin nga detyrimi për raportim.

Tarifat për kryerjen e aktverifikimit (me kërkesë të subjekteve)

Nr.	Rrethi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
1	Mirditë	89,700
2	Pukë	210,600
3	Kukës	215,800
4	Has	222,300
5	Mati	204,100
6	Bulqizë	213,200
7	Krujë, Tiranë	79,300
8	Kurbin	89,700
9	Shkodër	204,100
10	Lezhë	93,600
11	Malësi e Madhe	209,300
12	Dibër	218,400
13	Korçë	218,400
14	Berat	202,800
15	Devoll	223,600
16	Mallakastër	205,400
17	Tropojë	256,100
18	Skrapari	214,500
19	Elbasan, Peqin	81,900
20	Kolonjë	236,600
21	Gjirokastrë	245,700
22	Kavajë	81,900
23	Lushnjë	87,100
24	Librazhd	96,200
25	Vlorë	209,300
26	Përmet	218,400
27	Pogradec	205,400
28	Sarandë, Delvinë	248,300
29	Fier	102,700
30	Tepelenë	235,300

Tarifat për vënie në dispozicion të dokumentacionit (projekteve të zbatimit, me kërkesë të subjekteve)

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e vendosjes në dispozicion të dokumentacionit (projekteve të zbatimit)	100,000

ANEKSI 3

(shtuar me VKM nr. 506, datë 1.8.2024)

Tarifave për shërbimet e ofruara nga AKBN-ja, për shoqëritë mbajtëse të miratimit për impiantet e energjisë së rinovueshme (përveç HEC-eve)

Tarifa e Oponencës Teknike

Për centralet	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Me fuqi të instaluar deri në 1MW	500,000
Me fuqi të instaluar nga 1MW deri në 3MW	700,000
Me fuqi të instaluar nga 3MW deri në 10MW	1,000,000
Me fuqi të instaluar mbi 10 MW	1,500,000

Tarifat për certifikatën vjetore të monitorimit

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
0–0.5 mw	30,000
0.5–1 mw	80,000
1–2 mw	150,000
2–5 mw	300,000
5–10 mw	600,000
Mbi 10 mw	1,000,000

Tarifat për vlerësimin e investimit dhe certifikatën e pranimit të veprës

Emërtimi	Tarifa
Tarifa e vlerësimit të investimit dhe certifikatës së pranimit të veprës	1 % e vlerës së investuar, por në çdo rast nuk do të kalojë vlerën prej 15,000,000 lekësh pa TVSH

Penalitet për mosraportim sipas detyrimit kontraktual

Emërtimi	Vlera në lekë
Penalitet për mosraportim	100,000
Penalitet për përsëritje të shkeljes së mosraportimit	200,000

Vendosje e penalitetit nuk përjashton subjektin nga detyrimi për raportim.

Tarifat për kryerjen e aktverifikimit (me kërkesë të subjekteve)

Nr.	Rrethi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
1	Mirditë	89,700
2	Pukë	210,600
3	Kukës	215,800
4	Has	222,300
5	Mati	204,100
6	Bulqizë	213,200
7	Krujë, Tiranë	79,300
8	Kurbin	89,700

9	Shkodër	204,100
10	Lezhë	93,600
11	Malësi e Madhe	209,300
12	Dibër	218,400
13	Korçë	218,400
14	Berat	202,800
15	Devoll	223,600
16	Mallakastër	205,400
17	Tropojë	256,100
18	Skrapari	214,500
19	Elbasan, Peqin	81,900
20	Kolonjë	236,600
21	Gjirokastrë	245,700
22	Kavajë	81,900
23	Lushnjë	87,100
24	Librazhd	96,200
25	Vlorë	209,300
26	Përmet	218,400
27	Pogradec	205,400
28	Sarandë, Delvinë	248,300
29	Fier	102,700
30	Tepelenë	235,300

Tarifat për vënie në dispozicion të dokumentacionit (projekteve të zbatimit, me kërkesë të subjekteve)

Emërtimi	Tarifa në lekë (pa TVSH)
Tarifa e vendosjes në dispozicion të dokumentacionit (projekteve të zbatimit)	100,000